VENDIM
Nr.350, datë 25.2.1998

PËR HEQJEN E IMUNITETIT TË DEPUTETIT AZEM HAJDARI

Kuvendi Populllor në seancën e tij plenare, datë 25.2.1998, pasi dëgjoi propozimin e Komisionit të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores lidhur me kërkesën e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm për heqjen e imunitetit të deputetit Azem Hajdari, kërkesë të cilën ky Komision e ka miratuar dhe pasi e diskutoi këtë kërkesë dhe propozimin e Komisionit, mbështetur në nenin 22 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe neneve 85 dhe 90 të Rregullores së Kuvendit Populllor,

VENDOSI:

I. Të japë pëlqimin për heqjen e imunitetit të deputetit Azem Hajdari dhe dhënien e autorizimit organit të Prokurorisë për ndjekjen penale të tij për veprat penale të kundërshtimit me dhunë të punonjësve të Policisë si dhe për fyerjen për shkak të detyrës, parashikuar nga nenet 236/2 dhe 239/2 të Kodit Penal.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.